



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-049
Prishtinë, më 20 janar 2009, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 20 JANAR 2008

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, dhe anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Nexhat Daci, Naim Maloku, Xhezair Murati dhe Sllobodan Petroviq, ndërsa mungoi Ibrahim Gashi.

Nga grupet parlamentare: Safete Hadërgjonaj, Ardian Gjini, Mufera Sinik, Lutfi Haziri dhe Lulzim Zeneli, ndërsa munguan Ibrahim Makolli dhe Bojan Stojanoviq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Xheladin Hoxha, Skender Reçica dhe Sherif Konjufca;

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi dhe Eshref Vishi;

Nga NDI: Rinor Beka, dhe

Nga OSBE: Lelja Selimi.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje. Ai propozoi edhe dy pika shtesë, të cilat i miratoi Kryesia.

Kryesia i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 13.01.2009,
2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave, dhe
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 13 janar 2008

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 13 janar 2008, u miratua pa vërejtje.

2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare vendosi që seanca e radhës të mbahet **më 29 janar 2009**, me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për auditimin e brendshëm,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zonat ekonomike,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për rezervat shtetërore të mallrave,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/17 për mbrojtjen e konsumatorëve,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për gazin natyror,
9. Rekomandimi i Komisionit për Punë të Brendshme e Siguri dhe i Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media për Ligjin për gjendjen civile, dhe
10. Shqyrtimi i Raportit të Qeveris së Kosovës për vitin 2008.

3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave

3.1 Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri lidhur me situatën aktuale të sigurisë në Kosovë

Kryesia, pasi shqyrtoi Rekomandimin e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kryesia konstatoi se të gjitha komisionet parlamentare duhet t'i respektojnë të drejtat dhe përgjegjësit e veta konform Rregullores së Punës së Kuvendit.

3.2 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport për sigurimin e mjeteve të punës

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kryesia konstatoi se çdo komision parlamentar mund të pajiset me mjete të nevojshme për punë, nga mjetet e veta financiare, të destinuara për punën e komisioneve.

3.3 Shqyrtimi i kërkesës për kompensim të anëtarëve të Bordit të drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kryesia konstatoi se nuk është organ përgjegjës për caktimin e pagave për anëtarët e agjencive.

3.4 Shqyrtimi i kërkesës për kompensim të punës anëtarëve të Panelit për përzgjedhjen e kandidatëve për Avokat të Popullit

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet kompensimi i anëtarëve të Panelit për përzgjedhjen e kandidatëve për Avokat të Popullit në shumën prej 50€, ndërsa 30€ për stafin mbështetës të Panelit, për çdo mbledhje të mbajtur.
2. Kompensimi i çdo anëtari të Panelit dhe të stafit mbështetës duhet të realizohet për çdo mbledhje, sipas evidencës për pjesëmarrjen e tyre në mbledhje.

3.5 Shqyrtimi i kërkesës për shpalljen e Konkursit për një anëtar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës për shpalljen e konkursit për zgjedhjen e një anëtarit të këtij këshilli nga radhët e komunitetit serb në Kosovë.
2. Ngarkohet Administrata e Kuvendit t'i marrë të gjitha veprimet procedurale dhe ta shpallë konkursin për zgjedhjen e një anëtarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2008/12 për Shërbimin Civil të Kosovës.

3.6 Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet lidhur me implementimin e buxhetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2009

Kryesia, pasi shqyrtoi Rekomandimin e cekur më lart,

V E N D O S I:

1. Të implementohet Buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës në linjën buxhetore për paga dhe mëditje sipas kufijve buxhetor të përfshirë dhe të miratuar në Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009, sipas vendimit nr. 03-V-119/1.
2. Të ndahen mjetet për financimin e partive politike, të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës dhe të grupeve parlamentare për vitin 2009, si vijon :

I.

Në kuadër të buxhetit të miratuar për Kuvendin e Kosovës për vitin 2009, mjetet financiare nga kategoria -Subvencione dhe transfere paraqesin mjetet e ndara për financimin e partive politike, të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, në shumën prej 1.901.783€.

Këto mjete u ndahen partive politike sipas kriterit të vendeve të fituara në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, në shumën prej 1.812.240,72€, sipas Shtojcës nr.1.

II.

Për financimin e grupeve parlamentare ndahen mjete prej 5% nga mjetet e ndara sipas pikës I.

Këto mjete (5%) u ndahen vetëm grupeve parlamentare që përbëhen nga partitë politike, nga buxheti i paraparë për partitë e përfaqësuara në grupin parlamentar. Në rast të përbërjes së një grupi parlamentar nga dy ose më shumë parti, mjetet ndahen në proporcion sipas përfaqësimit të tyre në grupin parlamentar.

Mjetet iu alokohen grupeve parlamentare të Kuvendit të Kosovës, në shumën prej 89.542,28€, sipas Shtojcës nr.2.

3.7 Njoftimi i Grupit të punës lidhur me bisedimet e përfaqësuesve të dy grupeve të komunitetit serb

Xhavit Haliti, në emër të Grupit të punës, e informoi Kryesinë e Kuvendit se ata kishin biseduar me parashtruesit e kërkesave, veç e veç, Branisllav Grbiq, Dragisha Miriq dhe Vezira Emrush, për të qartësuar qëndrimet e tyre lidhur me kërkesën për dalje nga Grupi Parlamentar SLS dhe për nismën për formimin e Grupit Parlamentar “Zajedno”.

Ai tha se deputetët Branisllav Grbiq dhe Dragisha Miriq, edhe pas bisedimeve me anëtarët e Grupit punues kanë deklaruar se me vullnetin e tyre, pa presion nga askush, dëshirojnë që ta lëshojnë Grupin Parlamentar SLS dhe t’i bashkëngjiten Grupit Parlamentar “Zajedno”.

Gjithashtu, edhe deputetja Vezira Emrush, ka deklaruar se vullnetarisht dëshiron të dalë nga Grupi Parlamentar të AAK-së dhe t’i bashkëngjitet Grupit Parlamentar “Zajedno”.

Kryesia, pasi u njoftua me raportin e Grupit të punës, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Kryesia e Kuvendit u njoftua me krijimin e Grupit të ri Parlamentar “Zajedno”, në përbërje prej gjashtë (6) deputetëve: Sllavisha Pektoviq –SDSKiM, Vladimir Todoroviq- SDSKiM, Mihajlo Shqepanoviq-SNS, Dragisha Miriq-SKMS, Branisllav Grbiq-ND, dhe Vezira Emrush-SDA.
2. Kryetar i Grupit Parlamentar “Zajedno” është caktuar Sllavisha Petkoviq.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Hartoi:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale